

AKT THEMELIMI
PER KRIJIMIN SI PERSON JURIDIK TE SHOQERISE
" JPGP Group of Companies" SHPK

Ky akt themelimi u perpilua nga ortaku themelues :

Patrik Dardha , i biri I Ardianit-it, i lindur më 23.09.2002, lindur në Durrës dhe banues me adresë: Neki Libohova 00690579; Nd. 70; H. 1; Durrës; Durrës; 2006; Durrës, madhor, me zotësi të plotë për të vepruar, me numer personal:. K20923057P.

I quajtur me poshte ortak themelues, i cili ne perputhje me ligjin krijon nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar si vijon:

I. FORMIMI

1.1. Ortaku themelues formon nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar ne perputhje me ligjin nr. 9901 date 14.04.2008 per tregtaret dhe shoqerite tregtare.

1.2. Emri i Shoqerise


Emri i shoqerise do te jete: "**JPGP Group of Companies**" **SHPK**

1.3. Selia e Shoqerise

Shoqeria do te kete qendren e veprimtarise se saj ne rrethin e Durrës, Rr. Neki Libohova 00690579; Nd. 70; H. 1; Durrës; Durrës; 2006; Durrës.
Shoqeria ka te drejte qe me vendim te asamblese se ortakeve mund te hape dege. zyra, filiale ose perfaqesi te shoqerise ne qytete te tjera te Shqiperise,si dhe jashte Shqiperise.

1.4. Kohezgjatja e Shoqerise

Afati i veprimtarise se shoqerise do te jete i papercaktuar. Me vullnetin e asamblese se ortakeve, kjo shoqeri mund te mbyllet edhe para afatit, ne rastet kur kjo shoqeri humbet efektivitetin ekonomik per ortaket.


Patrik Dardha
PN

1.5. Objekti i veprimtarise

Shoqeria do te kete per objekt te veprimtarise se saj ne drejtim:

Import – Eksport mobilje te ndryshme, aksesore per mobilje, elektroshtepiake. Riparim dhe Montim mobiljesh, lende te pare te gatshme dhe gjysem te gatshme me shumice dhe pakice. Import dhe tregtim te makinerive, paisjeve te ndertimit, teknologjive te perpunimit dhe tregtimit te lendes drusore, aksesoreve, elektroshtepiakeve dhe te gjitha produkteve te mobilerise. Riparim dhe mirembajtje te mobiljeve dhe te artikujve te drurit. Ndertim dhe projektim te objekteve te ndryshme, shtepi, vila. Mobilje zbukurimi dhe aksesore. Dizajnet e ndertesave si dhe ato te kopshteve dhe zonave urbane, blerjen dhe restaurimin e mobiljeve antike dhe ne pergjithesi, Furnizimi dhe instalimi I materjaleve te cdo lloji per dysheme dhe veshje , mure, tavane etj,..

II. KAPITALI

2.1. - Kapitali

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 (njqind mije) Leke i ndare ne 1 kuote, kontribut i ortakut themelues ne masen:

Patrik Dardha 1 Kuote

Asambleja e ortakeve ka te drejte te beje shtese te kapitalit themeltar te shoqerise.

2.2 - Fitimi

Fitmi i realizuar nga aktiviteti i shoqerise i takon ortakeve themelues ne masen:

Patrik Dardha 100%

III. STRUKTURA JURIDIKE DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE

3.1 Organet e shoqerise jane:

1 - Asambleja e ortakeve

2 - Administratori i shoqerise

Administrator i shoqerise do te jete **Z.Patrik Dardha** me nr personal: **K20923057P**.

Patrik Dardha
PAJ

IV. DISPOZITE E FUNDIT

4.1. Ndryshimet ne kete AKT mund te behen vetem me shtese me shkrim dhe te miratuar nga asambleja e ortakeve.

Pjese e pandare e ketij akti eshte statuti i shoqerise i cili nenshkruhet rregullisht nga themeluesit e shoqerise.

4.2. Ky akt themelimi u hartua ne 4 kopje origjinale, i cili nenshkruhet rregullisht konform ligjit.

THEMELUESI

Patrik Dardha

Patrik Dardha



02/03/2024.